



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201502198/5

Tiranë ___/___/2016

Lënda : *Rekomandim për zbatimin e Vendimit nr. 1296, datë 04.06.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë*

Drejtuar : **Drejtorit të Policisë së Shtetit**
Z. Haki ÇAKO

Tiranë

I nderuar zoti Çako,

Me shkresën nr. K2/B39-2 Prot., datë 10.11.2015, ju kemi vënë në dijeni se, në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi B.M.. Ankuesi shkruan se, ka qënë pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit, në detyrën "Teknik Fluturues MI-8", në Repartin Special të Helikopterëve. Me Urdhrin nr. 2235, datë 27.06.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ai është liruar nga detyra. Meqënëse këtë urdhër e ka konsideruar të paligjshëm, ka ngritur padi në gjykatë ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Pas gjykimit të çështjes së tij, me vendimin nr. 1296, datë 04.06.2015, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, ndërmjet të tjerave ka vendosur:

"Shfuqizimin e Urdhrit nr. 2235, datë 27.06.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit si i dalë në kundërshtim me ligjin.

Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin B.M. me 12 paga mujore për lirim nga Policia e Shtetit në kundërshtim me ligjin.

Detyrimin e palës së paditur të paguajë pjesën e mbetur të papaguar të pagës së muajit Qershor 2014".

Për zbatimin e këtij vendimi gjyqësor, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Përmbaramit, por vendimi nuk është ekzekutuar nga i padituri. Ndërkohë ankuesi ka marrë takim me Drejtorin e Financës në Drejtorinë e Policisë së Shtetit. Nga ky i fundit është njoftuar se, vendimi gjyqësor nuk do të ekzekutohet sikurse përcakton gjykata në dispozitivin e tij, por duke u zbritur shuma e lekëve, 50% e pagës, të cilat i ka marrë konform ligjit pas liritimit nga detyra.

Këtë qëndrim të mbajtur nga Drejtoria e Financës në Drejtorinë e Policisë së Shtetit ankuesi e konsideron të padrejtë dhe në kundërshtim të plotë dhe të hapur me vendimin e gjykatës të cituar më lart.

Në bazë të kërkesës tonë, ju me shkresën nr. 7080/1 Prot., datë 01.12.2015, ndërmjet të tjerave na informuat se, ky punonjës është trajtuar me pagesë kalimtare referuar nenit 12 të Ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të forcave të armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës,..”. Sipas jush, meqënëse pala paditëse ka kërkuar shfuqizimin e aktit administrativ, gjykata absolutisht nuk duhet ta kishte pranuar këtë kërkesë, pasi referuar nenit 122/b të Kodit të Procedurave Administrative, akti administrativ që krijon të drejta të ligjshme nuk mund të revokohet/shfuqizohet. Pra gjykata, në kundërshtim me nenin e cituar më sipër, ka vendosur shfuqizimin e aktit administrativ duke ia hequr indirekt të drejtën e pagesës kalimtare paditësit.

Ju pretendoni se, në këtë rast, urdhri i lirim të ankuesit është shfuqizuar tërësisht nga gjykata duke përfshirë edhe pikën 4, ku përcaktohet trajtimi financiar me pagesë kalimtare.

Gjithashtu ju na informuat se, së fundmi Drejtoria e Policisë së Shtetit ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë kërkesë për interpretimin e këtij vendimi gjyqësor.

Nga përgjigjia e dërguar nga ana juaj konstatojmë se, ju nuk jeni dakort me këtë vendim gjyqësor dhe po vini në dyshim drejtësinë e tij. Vendimi nr. 1296, datë 04.06.2015, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë është i formës së prerë dhe në bazë të nenit 510/a të Kodit të Procedurës Civile ai është titull ekzekutiv dhe për rrjedhojë ekzekutimi i tij mund të bëhet edhe me detyrim nëpërmjet Zyrrave Përmbarimore. Pretendimet dhe argumentat e parashtruara në përgjigjen tuaj lidhur me kërkimet e paditësit në gjykatë, përfaqësuesi juaj duhet ti ngrinte parpara gjykatës gjatë gjykimit të kësaj çështjeje. Ndërsa pretendimi lidhur me padrejtësinë e këtij vendimi, duhej të ngrihej brenda afatit ligjor në Gjykatën e Lartë nëpërmjet recursit. Megjithatë, përderisa nga organet gjyqësore nuk është marrë ndonjë vendim për pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi, ai duhet zbatuar. Bërja e kërkesës për interpretimin e këtij vendimi gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, nuk legjitimon qëndrimin e mbajtur nga organi juaj për moszbatimin e tij.

Ndërkohë ju sjellim në vëmendje nenin 142/3 të Kushtetutës tonë, në të cilit parashikohet se: *“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”*.

Ndodhur në këto rrethana, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut nga administrata publike”* dhe në nenin 21/b të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*;

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e menjëhershëm të Vendimit nr. 1296 (137), datë 04.06.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë në favor të shtetasit B.M..

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda 30 ditëve konform nenit 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI